



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIMEVE PUBLIKE  
ZYRA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

**RREGULLORE  
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË KËRKESËS SË  
SINJALIZUESIT PËR MBROJTJEN NGA HAKMARRJA**

**BASHKIA PUKE**

KREU I  
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1**  
**Baza ligjore**

Rregullorja për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Pukë, bazohet në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ILDKPKI.

**Neni 2**  
**Objekti**

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në këtë Rregullore termet e më poshtë m kanë këtë kuptim:

“Autoritet publik” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën informimit.

“Hakmarrje” është do veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kercenim, i kryer nga organizata, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.

“I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligjit nr. 60/2016, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

“ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

“Mbrojtje” është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të ligjit nr. 60/2016.

“Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik të subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.

1 “Organizatë” është autoriteti publik ose subjekti privat.

“Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek një sia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.

“Sinjalizues” është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohë zgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktike të dyshuar korrupsioni.

“Subjekt privat” është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

“Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas kësaj ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

## KREU II VEPRIMET PROCEDURALE

### Neni 4 Mbrojtja kundër hakmarrjes

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas ligjit nr. 60/2016, mbrohet ndaj çdo masë hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organizata, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
  - a. shkarkimin nga puna;
  - b. pezullimin nga puna, ose të një, ose më shumë detyrave;
  - c. transferimin brenda ose jashtë organizatës;
  - d. uljen në detyrë;
  - e. uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
  - f. humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
  - g. mosngritjen në detyrë;
  - h. heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
  - i. vlerësime negative në marrëdhënien e punës;

- j. forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.
2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.
3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të institucionit, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, paraqet kërkesë me shkrim tek titullari dhe një kopje e saj i dërgohet Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.
4. Njësia përgjegjëse merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë. Në rast të mos miratimit apo moskthimit të përgjigjes brenda 5 ditësh nga data e paraqitjes së saj, ILDKPKI-ja, me kërkesë të sinjalizuesit, menjëherë i drejtohet organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për të urdhëruar autoritetin publik ose urdhëron subjektin privat të marrë të gjitha masat, sipas këtij neni.

### KREU III HETIMI ADMINISTRATIV

#### **Neni 5 Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje**

1. Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, fillimisht duhet të paraqesë kërkesë për mbrojtje tek njësia përgjegjëse.
2. Njësia përgjegjëse merr menjëherë masat dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkeljes së këtij afati, kërkesa e sinjalizuesit paraqitet tek ILDKPKI-ja, që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës për riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes.

#### **Neni 6 Bashkëpunimi**

Njësia përgjegjëse dhe sinjalizuesi bashkë punon me ILDKPKI-në në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e ëshajes së aktit të hakmarrjes ndaj sinjalizuesit. Njësia përgjegjëse është e detyruar të paraqesë informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara ILDKPKI-së.

- 1 Njësia përgjegjëse çdo deklaram apo argument të saj e paraqet me shkrim.

**Neni 7**  
**Mjetet e kërkimit të provës**

Gjatë hetimit administrativ Njësia përgjegjëse me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen mund:

- a të mbledhë deklaratat nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;
- të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
- b të vizitojë vende të caktuara.

**Neni 8**  
**Njoftimi i sinjalizuesit**

1. Njësia përgjegjëse njofton me shkrim sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për statusin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë.

**KREU IV**  
**AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT**

**Neni 9**  
**Afati i përfundimit të hetimit administrativ**

Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**MIRATON**  
**KRYETARI I BASHKISË**  
**GJON GJONAJ**